




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



KOMPANIA REGJONALE E MBETURINAVE "HIGJIENA" SH.A.
REGIONAL WASTE COMPANY "HIGJIENA" J.S.C. - REJONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJE OTPADA "HIGJIENA" D.D.

Në bazë të dispozitave të nenit 16 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L -087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës " nr.31) Vendimit të datës 460 /9.06.2011 , Komisioni Komunal i Aksionarëve , për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Higjiena" SH.A në Gjiçan, shpall :

K O N K U R S

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit të Bordit të Drejtorëve të KRM "Higjiena " SH.A.Gjiçan ,nga Komuna e Vitisë
Mandati i anëtarit të Bordit të Drejtorëve të zgjedhur nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve është deri me datë 5.03.2012 .

KOMPENSIMI I DREJTORËVE TË KRM "HIGJIENA"SH.A.Gjiçan

Kompensimi i Drejtorëve të Bordit të KRM "Higjiena "SH.A.Gjiçan do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20,pika 20.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike .

KUALIFIKIMET DHE PËRGADITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17,pika 17.3 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike ,një kandidat për t'u zgjedhur drejtor në Bordin e Drejtorëve duhet ti plotësojë këto kushte :

- të jetë person që ka integritet të njohur ,duke marrë parasysh , ndër të tjera,çfarëdo shkelje të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër ;
- të ketë përgaditje superiore;
- të ketë së paku 5 vjet pervojë pune në nivel të lartë të menaxhmentit – në fushën e administrimit të biznesit ,të financave korporative ,të financave ,të menaxhimit të thesarit ,të bankave ,konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencave - të ketë qenë kontabilist publik ,jurist i kualifikuar ,ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngusht me veprimtarinë afariste të NP – së

KUSHTET

Kandidati ka të drejtë të zgjidhet në Bordin e NPL –së, nëse :

- nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një Gjykatë kompetente ;
- nuk ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale ,përveq nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një Gjykatë ose organ tjetër i ankesave
- nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim
- nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të fundit

Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e NPL –së , nëse :

- aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 21 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike),menaxher i ndërmarrjes përkatëse ,ose cilësdo nga filialat e saja ;
- ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse ,ose cilësdo nga filialat e saja brenda pesë (5) viteve të kaluara ;
- aktualisht ka ,ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marëdhënie materiale afariste (përveq si konsumator individual I shërbimit të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse ,ose cilësdo nga filialat ,qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ;
- është aksionar ,drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik ,i cili ka marëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen publike përkatëse ;
- pranon ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse , ose nga cilado filialë e saj (përveq honorarit të drejtorit ose kompensimin stimuluës të përcaktuar me nenin 20.1 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike ,ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike përkatëse ,ose të cilësdo nga filialat e saja ;
- përfaqëson një aksionar ,i cili posedon mbi dhjetë përqind (10 %) të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatëse ;
- ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga dita e parë e zgjidhjes së tij ;
- është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e interesit financiar në nenin 2 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike), i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë e sipërpërmendura ;

- është zyrtar ,drejtor ose aksionar ,ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkuron me ndërmarrjen ,ose është menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon me shumë se dy përqind (2 %) të të drejtave të votimit),ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurojnë në ndërmarrjen ;
- është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ,ka qenë zyrtar i zgjedhur , i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike ;
- ka çfarëdo konflikti të interesave që ,për nga natyra ,do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive , me besnikëri ,në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike .

INFORMATË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtor në bordin e Ndërmarrjes publike , KRM "Higjiena " SH.A.Gjilan duhet t'i dorëzojnë provat e mëposhtme :

- CV- në,
- Letër motivimin ;
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshminë e kualifikimit profesional ;
- Dëshminë mbi përvojën e punës ;
- Certifikatën që s'është nën hetime dhe
- Certifikatën e lindjes.

Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim ,në të cilin deklaron se ai /ajo i përmbushë kushtet e kualifikimit ,pavarsinë dhe përgaditjen profesionale Çdo përgënjeshtim material ,qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca , ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm .

Dokumentacioni duhet të jetë në zarf të mbyllur dhe dorëzohet në zyrat e personelit të Komunës së Vitisë ,të adresuara për Komisionin Komunal të Aksionarëve të KRM "Higjiena " sh.a Gjilan .

Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor ("Koha ditore" dhe "Zëri ") prej dates 10.06.2011-17.06..2011

Informatat shtesë mund të sigurohen përmes anëtarit të K.K.A . nga Komuna e Vitisë z.Agim Haziri

Gjilan, me 09.06.2011.

**Komisioni Komunal i Aksionarëve
për KRM "Higjiena "SH.A. Gjilan**
